



NJOFTIM VJEOR MBI MARRJEN E MIRATIMIT PËR NXJERRJEN E TË DHËNAVE

Department of Education (Departamenti i Arsimit) mund të marrë fonde shtesë për disa nga shërbimet që u ofrohen nxënësve si fëmija juaj, të cilët kanë plane individuale arsimit (IEP-ë). Me qëllim që shkollat tona të marrin këto fonde, më parë keni nënshkruar një formular miratimi (1) për të aksesuar dhe për t'i dhënë programeve shtetërore dhe federale të Medicaid informacion personalisht të identifikueshëm nga të dhënat e arsimit special të fëmijës suaj, lidhur me vlerësimet, programet dhe shërbimet që i ofrohen atij, si edhe (2) për të aksesuar përfitimet Medicaid të fëmijës suaj për të paguar për këto shërbime. Kjo letër njoftimi vjetor është për t'ju kujtuar se me nënshkrimin e mëparshëm të këtij formulari miratimi, ju keni kuptuar dhe keni rënë dakord që New York City Department of Education (Departamenti i Arsimit i Qytetit të Nju-Jorkut) të mund të përdorë përfitimet publike ose sigurimin e fëmijës suaj për të paguar shërbimet e arsimit special të ofruara për ose në emër të fëmijës.

Faleminderit për ndihmën tuaj në sigurimin që shkollat tona publike të marrin sa më shumë fonde të jetë e mundur për mbështetjet e rëndësishme që u mundësohen nxënësve tanë.

Çfarë informacioni rreth fëmijës tim do t'u jepet programeve shtetërore dhe federale të Medicaid?

New York City Department of Education (Departamenti i Arsimit i Qytetit të Nju-Jorkut) (NYC DOE) do të japë informacion në lidhje me vlerësimet dhe shërbimet e arsimit special që i janë ofruar fëmijës suaj. Ky informacion mund të përfshijë IEP-në, shënimet mbi progresin, të dhëna mbi mungesat, vlerësimet, si edhe të dhëna dhe informacione të tjera në lidhje me vlerësimet dhe shërbimet që i janë ofruar fëmijës suaj.

A ka ndonjë kosto për mua apo familjen time?

Nuk ka asnjë kosto për ju apo për familjen tuaj. Nuk do t'ju kërkohet të përballoni asnjë shpenzim, pagesë mujore (premium), kosto apo bashkëpagesë për ofrimin e këtyre shërbimeve. Shërbimet që i ofrohen fëmijës suaj, si brenda ashtu edhe jashtë shkollës, nuk do të ndikohen në asnjë lloj forme. Nëse familja juaj përfiton nga Medicaid, mbulimi juaj nuk do të anulohet, mbulimi jetëgjatë nuk do të reduktohet dhe shërbimet që merrni nuk do të ndikohen në asnjë lloj forme nga marrja e përfitimeve të Medicaid. Nuk do t'ju kërkohet të regjistroheni apo të përfshihen në Medicaid, me qëllim që fëmija juaj të marrë shërbimet në IEP-në e tij/saj. Nuk do të rrezikoni humbjen e të drejtës për përfitime shërbimesh në shtëpi apo në komunitet, nëse ka, që bazohen në shpenzimet tuaja totale të lidhura me shëndetin.

A mund ta ndryshoj mendimin lidhur me lejimin e NYC DOE për të pasur akses në informacionin e fëmijës tim dhe për të paraqitur kërkesa për rimbursim në programin Medicaid, si dhe ta tërheq miratimin tim?

Po - mund ta ndryshoni në çdo kohë mendimin tuaj në lidhje me këtë miratim. Për të ndryshuar vendimin tuaj, kontaktoni shkollën e fëmijës dhe kërkonin të plotësoni një formular të ri miratimi për Medicaid. NYC DOE duhet gjithsesi t'i ofrojë fëmijës suaj shërbime dhe arsim special pa asnjë kosto për ju, edhe nëse e tërhiqni miratimin tuaj më vonë.